- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entitkontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të

ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 tëLPP dhe nenin 75 tëVKM 285/2021, të ndryshuar.

- 3.Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
- 4.Nëse, AutoritetiKontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për tënjëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

EKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i OfertësEkonomike

Shtojca2: Formulari i Ofertës Ekonomikenë rastine procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca8: Formularii Krieteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit,pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14:Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur nëvlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa vlerëdo të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

LOTI I:

1-SHEQER

Treguesit shqisorë.

- 1. Pamja e jashtme:** Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
- 2. Ngjyra:** e bardhë dhe me shkëlqim.
- 3. Shija dhe era:** Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

4. **Tretshmëria:** Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shteteror 1413-87.

- Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thata jo më pak se 99,6%.
- Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.
- Lagështia jo më shumë se 0,16%.
- Hiri jo më shumë se 0,07%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thasë 50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto e neto.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin SHEQER të perputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shteteror 1413-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

2. ORIZ

Treguesit shqisorë.

1. **Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.

2. **Ngjyra:** E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

3. **Era dhe shija:** Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thatë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shteteror 1738-87.

- Lagështia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.
- Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12%.
- Lëndë minerale nuk lejohen.
- Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %.
- Kokrra të pazhvilluara, jeshile, të pazhveshura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thasë 25-50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto ose neto.

Afati i skadences të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marre brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin ORIZ të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shtetëror 1738-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

3. MAKARONA

Treguesit shqisore.

1.**Forma:** Makarona spageti me gjatësi jo më të vogël se 30 cm, me trashësi deri 2,4 mm.

2.**Pamja e jashtme:** Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

3.**Ngjyra:** E bardhë me nuancë të verdhë , ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

4.**Era dhe shija:** E mirë karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thatë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1170-87.

- Lagështia jo më shume se 13%.
- Aciditeti: Acid sulfurik jo më shumë se 0,16%.
- Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
- Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

1. Në letër ambalazhi të pastër ose polietileni me masë 500 gr ose 1 kg të futura ne kuti kartoni deri në 20 kg. Në çdo pako shmangie në masë deri + - 2%.

2. Në ambalazh të jetë shënuar dhe afati i skadencës. Afati i skadences të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të kete lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që përfaqësojnë artikullin MAKARONA të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikimet teknike dhe të **Standartit Shteteror 1170-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues.

4.VAJ

Treguesit shqisorë.

- 1.Pamja në 20⁰ C : Lëng vajor, i qartë, pa depozitime.
- 2.Ngjyra : E verdhë e lehtë.
- 3.Era dhe shija : E mirë karakteristike e vajit , pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.
4. Përmbajtja e acideve yndyrore sipas S SH 203:2003.

Treguesit fiziko – kimikë.

- Dendësia relative në (20⁰ C/ujë në 20⁰ C) 0,918-0,923.
- Treguesi i refraksionit =1,461-1,468.
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj) 188-194.
- Treguesi i jodit 118-141.

-
- Lëndë të pasapunifikueshme : $\leq 15 \text{ gr/kg}$.
 - Lëndët fluturuese në 105 gradë C jo më shumë se 0.2%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Vaj rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litër ose shumëfishet e tyre deri në 5 litër, të mbyllura me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Shmangia nga vëllimi është deri $\pm 1\%$.

Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet:

Emërtimi i plotë i mallit, data e prodhimit, afati i përdorimit.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë ose me material tjetër të përshtatshëm.

Raport analiza të jetë marrë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të ketë lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që përfaqësojnë artikullin VAJ të përputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikime teknike dhe të **Standartit Shtetëror 203-2003**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s'kualifikues.

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr.9863 datë 28.1.2008.

Firma fituese do ta shoqërojë mallin me certifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit fiziko-kimikë.

5. Salcë domatesh

Kërkohet salcë domate e amaballazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi.

Kutia të jetë e mbyllur hermetikisht dhe e mbështjellë me etiketë të përkthyer në gjuhën shqipe kur malli është i huaj.

Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.

Përbërja e lëndës së thatë të jetë $20 \% \pm 1$.

Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja.

Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.

Shija të jetë karakteristike e salcës së domates pa shume aciditet.

Aroma të jetë e këndshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit.

Në etiketë të jetë shënuar qartë firma prodhuese, data e prodhimit dhe përdorimit.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1429-87.

6.Kripë ushqimore

Të jetë e cilësisë së parë, e ambalazhuar në pako 0.5 deri 1 kg.

Pamja: masë kokrrizore me ngjyrë të bardhë.

Me shije karakteristike të kripur, pa shije dhe erë të huaj, e tretshme plotësisht në ujë.

Në ambalazh vendoset etiketa ku shënohet lloji i kripës, origjina e mallit.

Ruhet në vende të pastra dhe të mbrojtura nga lagështira e lëndët kimike.

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr. 9863 datë 28.1.2008.

Firma fituese do ta shoqërojë mallin me certifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit fiziko-kimikë.

7.Vezë

Sipas Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

Të jenë me peshë 63 deri 73 gr për /kokërr.

Të jenë të pastra, të thata, pa aroma të pakëndshme, të mbrojtura efektivisht nga tronditjet dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me diellin, sipas kërkesave specifike të higjienës bazuar në Udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazuara në kuti kartoni ose arka. Shenjat për numrin e dallueshëm të prodhuesit, datës së skadencës të jenë mbi vezë ose mbi ambalazhin e tyre, ose mbi të dyja, ose në vende të dukshme të tyre sipas rregullores së sipërpërmendur.

8.MIELL GRURI

Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

E bardhë

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i ambalazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

9.VAJ ULLIRI; STASH 102- 87

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.
2. Ngjyra: të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.
3. Shija dhe era: karakteristike të vajit të ullirit. Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Aciditeti: Nuk duhet të kalojë 0.5 %

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi duhet të jetë në shishe 0.5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standartet.
2. Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjerë dhe konservantë.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

10.LENG LIMONI

Te jete me karakteristike te limonit.Ambalazhimi te jete ne shishe plastike 330 ml dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.

.

11.AMITA 200ML

Kërkesat cilësore Frutat që përdoren të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi. Ato të jenë të pastra, të pjekura, të freskëta, të pa prekura nga dëmtuesit e sëmundjet dhe pa dëmtues mekanikë. Treguesit shqisorë: - Pamja e jashtme: Lëng me turbullirë të lehtë pa lëndë të huaja. Në pezulli lejohet turbullira e pulpës karakteristike e frutit. - Ngjyra: Karakteristike e ngjyrës së frutit me të cilin është prodhuar. - Era dhe shija: Karakteristikë e frutit të përdorur. Treguesit fiziko - kimik: - Lëndë të thata, %, sipas refraktometrit, jo më pak se: $8 \pm 0,3$. - Acide organike (citrik e tartrik), %, jo më shumë se: 0.2. - Ngjyruar ushqimorë, %, jo më shumë se: 0.010. - Gaz karbonik; %, në masë jo më pak se: 0.3. Uji i sheqerit dhe gazi karbonik që përdoren për përgatitjen e pijeve freskuese të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi. Lejohet për ngjyrim, të përdoret edhe karamel (sheqer i djegur). Ambalazhimi Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Pijet freskuese ambalazhohen në shishe të pastra plastike, kërkesave të AK-së. Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen: - Emri i prodhuesit, - Pesha neto, - Data e prodhimit, - Data e skadimit, - Kushtet e vecanta të ruajtjes. 47 | Faqe Verifikimi i kërkesave cilësore Marrja në dorëzim bëhet me parti. Në çdo parti verifikohet: o Ambalazhimi dhe etiketimi; o Vetitë organo – shqisore dhe fiziko – kimike. Karakteristikat kimike dhe bakteriologjike garantojnë nga prodhuesi për çdo parti prodhimi. Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi

12.RIGON

Te jete i bluar imet,pa lageshtire ne amballazh,me arome dhe shije te kendshme . Ne amballazh te jene te dukshme pesha, afati i skadimit, te dhenat e subjektit ku jane prodhuar,Malli nuk duhet te skadoje para 6 muajave nga data e depozimit ne AK.

13.PIPER I KUQ

Te jete i bluar imet,pa lageshtire ne amballazh,te jete djeges..

14.PIPER I ZI

Te jete i bluar imet,pa lageshtire ne amballazh .

Artikujt e tjere te pa cilesuar me siper jane sipas specifikave te preventivit bashkeliudhur.

LOTI II:

1.FASULE

Treguesit shqisorë.

1.**Pamja e jashtme:** Kokrra të plota, të shëndosha,me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale , e rrumbullakët, e gjatë etj).

2.**Ngjyra:** e bardhë.

3.Era dhe shija: Pa erë myku dhe cfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose cfarëdo ere tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1723-87.

- Lageshtia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.
- Kokrra të thyera jo më shumë se 13%.
- Perzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.
- Dëmtime mekanike ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thase 25-50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto ose neto.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

Raport analiza të jetë marë brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të tenderit dhe të kete lidhje me mostrën e paraqitur ku të jetë e shënuar në të: emërtimi i mallit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me mostrën e paraqitur.

Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të mostrës që perfaqësojnë artikullin FASULE të perputhen plotësisht me treguesit e lartshënuar në specifikimet teknike dhe të **Standartit Shtetëror 1723-87**. Çdo mospërputhje e treguesve të mësipërm është kusht s`kualifikues

2.PATATE

Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.Kokrra të jetë e pjekur.

Madhësia e kokrrës për të rrumbullaktat të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm, për vezaket për dimëroret dhe veroret 4 cm.

Nuk lejohen të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime nga dosa dhe të papastruara nga dherat.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1729-88.

Duhet të jenë të ambalazuara në thasë rrjete 25 deri ne 30 kg(polietileni).

3.KARROTA

Kërkohet e cilësisë së parë të padeformuara dhe me ngjyrën karakteristike të kultivarit. Gjatësia jo më pak se 10 cm, nuk lejohen kalbëzime, ndryshk nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë jeshile pasi janë shkaktare të aciditetit dhe sëmundjeve.

Të thata dhe të zverdhura nuk lejohen.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1712-88.

4.MOLLE

Kërkohet cilësia e parë, me formë,ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njëjtë, të shëndosha, të pastra, të zhvilluara normalisht, pa erë e shije të huaja.Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa defekte rreth bishtit.

Dëmtime të ndryshme mekanike lejohen deri në dy njolla jo të zeza, të vogla, të lehta për kokërr.Nuk lejohen të kimbura.Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.Gunga në lëkurë nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen më tepër se deri në ¼ e sipërfaqes së frutit.

5.QEPË E THATE

Kërkohet cilësia e parë,të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4 deri ne 5 cm.

Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.

Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira, te kalbura e të mykura nuk lejohen.

Ambalazhimi në thasë polietileni me peshë deri në 10-20 kg.

6.PERIMET

Te jenë të cilësisë së parë,të freskëta,jo te vyshkurate ambalazhuara ne menyre qe te mos demtohen gjate transportit .Transporti i perimeve te behet me mjete te pastera duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportin e produkteve ushqimore

7.FRUTAT

Duhet të jenë të shëndosha, pa ndryshime cilesore dhe humbje në peshë, pa difekte, të pa vyshkura, të madhësisë dhe formës së rregullt.

Mollët, bananet duhet të kenë peshë për çdo kokërr 180-200 gr.

Frutat e tjera sipas kërkesës së tregut.

Nuk lejohen të jenë të ngrira, gërvishje në sipërfaqe dhe pa erëra të huaja.

Nuk duhet të kenë dëmtime mekanike

Ambalazhimi duhet të jetë në arka druri, kartoni, plasmasi të pa dëmtuara.

8. ZARZAVATE TE STINES

Kerkohet cilesie pare, te fresket ne varesi te stines

LOTI III: Bulmeti.

Qumeshti

(I pasterizuar dhe ambalazhuar ne tetra ose prizma pak) duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te kete karakteristikat tipike te qumeshtit i cili ka pak ngjyre te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17-19, ngarkesa mikrobike 1-2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10-12. Furnizimi do te behet sipas kerkeses se AK Qendres Balneare Peshkopi me mjetet e furnitorit. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetesise. Prodhimi te jete i shoqeruar me certificate te analizes te bere nga laborator i veterinar. Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor. Pamja e jashtme: Leng i njellojte (homogjen), pa lende te huaja qe duken e notojne, ose bien ne fund. Me rrjedhje te njellojte pa nderprerje.

Ngjyra. E bardhe e njellojte me nuance te lehte te verdhe.

Shija dhe era. E kendshme, lehtesisht e embel, me shije te lehte zierje, pa shije dhe ere te huaj.

Gjalp i fresket- Bazuar ne Stazh 1445/87

Treguesit shqisore:

1. Pamja: E njetrajtshme, pa shtresa, ne prerje e siperfaqe te shenditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.

2. Ngjyra: Krem deri ne te verdhe te celur.

3. Era dhe shija: E kendshme, karakteristike e gjalp it pa ere shije te huaj.

Treguesit kimik:

Lageshtira ne %, jo me shume se 17.

Lende e thate pa yndyre ne e %, jo me shume se 2.

Kripe ne %, jo me shume se 2 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike Brenda normave te lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Amballazhimi: Amballazhohet ne kuti kartoni te vazezuar me mase 1 – 5 kg, te veshur nga brenda me leter pergamen.

Mbi cdo ambalazh me gjalpe vendoset etiketa ne te cilen shenohen: Emertimi i prodhesit, Emri i produktit, Pesha neto os vellimi i produktit, Data e prodhimit.

Kushtet e vecanta te ruajtjes

Rekomandime per perdorim, nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimore. Keto te dhena te jepen mbi ambalazh ose mbi etikete. Etiketa e produktit te amballazhuar duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga ambalazhi. Shenimet e detyrueshme te marketimit duhet te jene te qarta, te dukshme mire, te pashlyeshme dhe lehtesisht te lexushme ne kushtet normale te blerjes dhe perdorimit.

N.q.se eshte i mbuluar me nje material veshes te gjitha informacionet e detyrueshme duhet te figurojne mbi kete te fundit ose etiketa e ambalazhit duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Emri i produktit ushqimor dhe permbajtja neto duhet te bjere ne sy qe ne pamje te pare. Nqs gjuha ne etiketen origjinale nuk eshte e pranueshme per konsumatorin per te cilin ajo eshte destinuar duhet te perdoret nje etikete shtese qe permban informacionin e detyrueshem ne gjuhen shqipe. Ne rastin kur etiketa eshte zevendesuar, apo plotesuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet te jene pike per pike si te etiketes origjinale.

Malli te shoqerohet me flete analize laboratorike, certificate origjine.

Ruajtja dhe transportimi: Gjalpi ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4°C.

Transportimi i gjalpit nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike. Transportimi behet me mjet te mbuluar e te paster, i cili eshte i destinuar per transportimin e prodhimeve ushqimore.

Djath i bardhe

Kerkohet cilesia e pare prodhim vendi me baze djath nenprodukt i qumeshtit lopes, deles ose dhise.

Nuk lejohet prodhimi i djathit me perzierje qumesht pluhur.

Ngjyra sipas llojit te te qumeshtit qe prodhohet djathi, nga qumeshti i lopes ngjyre krem, nga qumeshti i deles dhe dhise – ngjyre te bardhe ne krem. Lejohet djathi me perqindje yndyre jo me shume se 3 % yndyre. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze, karakteristike e djathit te stazhionuar mire.

Era karakteristike e djathit normal pa era te tjera te pa kendeshme.

Amballazhimi te jete ne rrota te rafinuara 3-5 kg.

Malli te jete i shoqeruar me certificate te cilesise dhe standarteve te miratuara.

Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, date e stazhionimit dhe data e skadimit, ne certifikate te jete shenuar edhe origjina e mallit.

-Cdo parti malli te pajiset me raport analize nga D B U M K per tu mbrojtur nga fallsifikimet qe behen per keto produkte dhe dorezohet prane magazines se Qendres Balneare Peshkopi, se bashku me dokumentacionin perkates.

-Dokumentat qe do te shoqerojne keto mallra do te jene: fletedaljet e shitesit me te gjithë ekstremet, certifikate sanitare – veterinare, flete analize nga inspektori veterinary

LOTI IV:

- Kërkohet mish viçi në rritje me cilësiqë të plotësojë kërkesat e standartit shtetëror Nr 1441, te vitit 1987.
- **Pamja e jashtme :**
 - - Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje.
 - - Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëhere pas prerjes të jetë i tejdukshëm.
 - - Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.
- **Ngjyra :** Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjamt të jetë me ngjyrë të bardhë.
- **Konsistenca :** Të jetë e butë dhe elastik. Në prerje të duket kompakt.
- **Era :** Të jetë e këndshme, karakteristike e llojit te produktit.
- **Palca e kockave :** Të mbushi të gjithë kanalin e palcës, ngjyra të jetë rozë në të verdhë.
- Mishi përbëhet nga pjesa e përparme dhe pjesa e prapme proporcionalisht. Koka, mëlçia e zezë, e bardhë, këmbët si dhe të përbrendshmet nuk futen në përbërje të mishit.
- **Çdo pjesë anatomike të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.**
- **Çdo ndarje mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.**
- Peshimi i mishit do të bëhet ne momentin e marrjes ne dorezim nga personat e autorizuar prane Qendres Balneare dhe ne te gjitha rastet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.
- Transporti i mishit do të bëhet me mjetet e subjektit fitues të tenderit, mjeti të jetë i përshtatshëm për transport mishi, **(mjet frigoriferik).**

LOTI V:

Buka e grurit do te prodhohet me miell rreze 70 % i stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete i fresket me ngjyre, ere, shije dhe lageshtire konform standarteve perkatese te miellit me rreze 70 %. Mielli duhet te kete asnje lloj lende te huaj. Buka duhet te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjaftueshem. Shija, era lageshtira dhe aciditeti

i bukes duhet te jete konform standartit teknik te prodhimit te saj. Korja e bukes duhet te jete e lemuar, pa djegje, pa shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte ne te gjithë siperfaqen. Tuli duhet te jete I pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithë vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko-kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1 (nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5%, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane Qendres Balneare ‘‘Enver Shehu’’ Peshkopi sipas kerkeses. **Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster, te jete ne qese letre dhe te siguroje mos demtimin e saj.**

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NR.	PERSHKRIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
	Loti I				
1	Veze	kokrra	8000		
2	Makarona	kg	850		
3	Miell	kg	250		
4	Vaj	litra	370		
5	Vaj ulliri	litra	135		
6	Piper I kuq	pako	80		
7	Leng limoni	litra	60		
8	Salce shishe	kg	130		
9	Piper i zi	pako	250		
10	Rigon	pako	250		
11	Kripe e jodizuar	kg	150		
12	Amita 200 MI	cope	2000		
13	Oriz	kg	500		
14	Sheqer	kg	330		
	Shuma-1				
	Loti II				
1	Domate	kg	275		
2	Tranguj	kg	120		
3	Laker	kg	135		
4	Patate	kg	210		
5	Speca	kg	300		
6	Qepe e thate	kg	200		
7	Presh	kg	90		
8	Hudher e thate	kg	7		
9	Fasule	kg	80		

10	Patellxhan	kg	70		
11	Bamje	kg	35		
12	Spinaq	kg	40		
13	Kunguj	kg	20		
14	Bishtaja	kg	28		
15	Karrote	kg	35		
16	Nektarina	kg	50		
17	Molla	kg	300		
18	Banane	kg	200		
	Shuma- 2				
	Loti III				
1	Qumesht lope I pasterizuar	liter	3000		
2	Djathe lope(I bardhe vendi)	kg	340		
3	Gjalp	kg	270		
	Shuma-3				
	Loti IV				
1	Mish viçi	kg	860		
	Shuma-4				
	Loti V				
1	Buke gruri 1 kg	cope	2700		
	Shuma-5				
	Shuma1+2+3+4+5				
	T.V.Sh-20%				
	Shuma totale				

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shenim: Oferta ekonomik nga operatorët ekonomik do të paraqiten sipas shtojcave perkatëse të DST.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
